

STATUTI **SHOQERIA ALBANA & ARJANI**

Lezhë, më 03.09.2025

KREU I

KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE.

Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar **ALBANA & ARJANI** me ortak te vetem,

1. **Z. Isa Berisha** me atësi Ramadan, amesia Nuriye, shtetas Kosovar i datelindjes 13.05.1954, lindur dhe banues ne Kramovik, Rahovec, Kosove, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjofimit nr. ID0658792 dhe me nr. personal 1250198899.

E hartojmë këtë Statut te Shoqërisë mbështetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshtë:

Neni 1

Krijimi

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj.

Emërtimi i shoqërisë është **ALBANA & ARJANI**. Kjo shoqëri është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaket e shoqërisë", te cilet përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri ne pjesën e pashlyer te kontributeve te nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbëjnë kapitalin e regjistruar te shoqërisë.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë ne Lezhe, Shenkoll, Tale, zk 1879, pasurine nr. 6/115. Shoqëria mund te ndryshoje selinë e saj, te hape zyra përfaqësie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te asamblesë se ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqëria do te ketë për objekt te veprimtarisë te saj ushtrimin e aktivitetit ne fushën e : Ndermjetesim ne shitblerje pasuri te luajtshme dhe paluajtshme.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore te pacaktuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jete: **100,000 (qind mijë) leke** e përbërë nga 1 (nje) kuota që i perkasin ortakeve si me poshte.

1. - Isa Berisha me 100 % te kapitalit = 1 kuote = 100,000 leke

Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar e shlyer krejtësisht.

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlere të tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund të jete ne para ose ne natyre (pasuri të luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtroje të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejte t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit të shkaktuar, si pasoje e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me ane të kontributeve ne natyre, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Ne asnjë rast shumica nuk mund të detyroje një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

Ne të gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për ndryshimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të behet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakeve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi qe kalon kuotën dhe ai qe e fiton atë përgjigjen ne mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Biznesit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Biznesit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndërmjet ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme me rruge trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratoreve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;
 - d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kësaj pike;
 - dh) Mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
 - j) Te gjithë veprimet qe kane te bëjnë me shitjet - blerjet, lidhjet e kontratave me te tretet te çdo lloji, me organet qendrore etj do te kryhen administratorii shoqerise .
 - l) Ndarja e fitimit dhe shpërblimi midis ortakeve do te behet me vendim te asamblesë se ortakeve.
 - m) Administratori i shoqërisë nuk mund te veproje si përfaqësues i ortakeve ne asamblenë e përgjithshme.
- Autorizimi mund te jepet vetëm për një mbledhje te asamblesë se përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me te njëjtin rend dite.

Neni 10

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite përparadatës se parashikuar përmbledhjen e asamblese. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaket janë dakord, për të marre vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, qezotërojnë me shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë përçështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marre vendime të vlefshme vetëm, nëse ortaket që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vone se 30 dite, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shndërrimin në një formë tjetër, transferimin e kuotave, emërimin e eksperteve dhe likuidatorëve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme, të cilat janë të vlefshme, kur në të janë të pranishëm ortaket me të drejtë vote që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të kuotave të kapitalit të shoqërisë të cilët votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji 9901 datë 14.04.2008 dhe merren vendime të vlefshme me votimin pro të 3/4 të ortakeve pjesëmarrës. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, kur në të marrin pjesë ortaket me të drejtë vote të cilët zotërojnë me shumë se 30 për qind të kuotave përçështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratoreve; e

c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;

c) përcaktimin e shpërblimeve,

d) mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecuresë se veprimtarisë;

d) përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKB për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 13

Administrimi

Shoqëria do te administrohet nga një Administrator.

Administrator i shoqërisë emerohet **Z. Isa Berisha** me atësi Ramadan, amesia Nuriye, shtetas Kosovar i datelindjes 13.05.1954, lindur dhe banues ne Kramovik, Rahovec, Kosove, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. ID0658792 dhe me nr. personal 1250198899 i cili do te ushtroje detyrat e administrimit sipas statutit dhe ligjit për një periudhe 5 (pese) vjeçare me te drejte ripërtëritje.

Neni 14

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

a) kryeje të gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësoje shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë;

c) Te nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë se veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë se përgjithshme për miratim;

d) krijoje një sistem paralajmërimi ne kohen e duhur për rrethanat, qe kercenojne mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryeje regjistrimet dhe dërgojnë te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare te Biznesit.

e) raportoje përpara asamblesë se përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

f) Administratori ka te drejte te përfaqësoje shoqërinë përpara organeve te drejtësisë, gjykatës e prokurorisë, organeve te administratës shtetërore qendrore apo lokale, zyrës se tatimeve, bankave etj.

-Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit te zakonshëm te shoqërisë.

Neni 15

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te tretëve, për shkelje

te ligjeve, për shkelje te statutit, apo për faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë..

Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e përgjithshme te detyrimit te besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te përcaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirëbesim e ne interesin me te mire te shoqërisë ne tërësi, duke i kushtuar vëmendje te veçante ndikimit te veprimtarisë se shoqërisë ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetëm për arritjen e qëllimeve te përcaktuara ne këto dispozita;

c) te vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për te cilat merret vendim;

g) te parandaloje dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo te mundshëm, to interesave personale me ata te shoqërisë;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne mënyrë te arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vlerësimit te informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me to kane realizuar nga këto veprime te parregullta. Administratori ka barrën e provës për te vërtetuar kryerjen e detyrave te tyre ne mënyrë to rregullt e sipas standardeve te kërkuara.

4. Ne mënyrë te veçante, po pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet e ,shkaktuara, nëse, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakevekontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

c) lejon qe shoqëria te vazhdoje veprimtarinë tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqëria nuk do te kishte aftësi paguese për te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kane te drejte to ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i është shkaktuar shoqërisë, përfshire edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund te ndaloje ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit to detyrës.

Neni 16 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17
Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18
Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Te ardhurat neto që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakeve.

Neni 20

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatë, për të caktuar një likuidues.

Neni 21

Likuiduesi merr përsipër te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron me shume se një likuidues, pervecse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht te drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnënjërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 22

Baza Ligjore

Shoqëria do të ketë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24

Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua, në parim nën për nën nga Ortaket e shoqërisë tregtare dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

1. Isa Berisha

